



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.00.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Shqyrtimi i projektligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar".

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Myslim Murrizi, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Luan Duzha, Luan Harusha, Spartak Braho, Elena Xhina, Anduel Xhindi, Eljo Hysko, Edmond Rrushi, Lefter Maliqi, Nimet Musaj, Ylli Shehu, Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj dhe Arben Elezi.

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Romina Hoxha - Specialiste pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Behar Salillari – Specialist në Komisionin për Statusin e Dëshmorëve

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Së pari, më lejoni që t'i uroj mirëseardhjen kolegut Nimet Musaj, i cili i bashkohet Komisionit për Sigurinë Kombëtare, si anëtar i përhershëm i tij.

Mirë se erdhët, zoti Musaj!

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar shqyrtimin e projektligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar"", të ndryshuar".

Për të prezantuar këtë ndryshim që është bërë në ligj kemi të ftuar: zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, zonjën Romina Hoxha, specialiste pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe zotin Behar Salillari, specialist në Komisionin për Statusin e Dëshmorëve.

Mirë se keni ardhur!

Është një ndryshim i vetëm që propozohet në ligjin "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar". Pa humbur kohë, duke respektuar detyrimet, dhe për këtë do të kërkoj mirëkuptimin e të gjithë kolegëve, për shkak se është duke u zhvilluar një konferencë ndërkombëtare për disa ditë, e cila moderohet nga zoti Koçi, të mund ta shfrytëzonim kohën maksimalisht për ta lejuar më pas zotin Koçi që të vijojë me punimet e konferencës.

Fjala është për ju zoti Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë, anëtarë të këtij komisioni, projektligji që paraqesim sot është shumë i shkurtër, por është kuptimplotë dhe lidhet me vlerësimin maksimal që i bën qeveria dhe maxhoranca vlerave të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe respektimit të veteranëve të kësaj lufte. Me kërkesën e Organizatës Kombëtare të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për të shpallur datën 20 korrik si ditën e veteranit të kësaj lufte. Ministria në fillim dhe pastaj qeveria aprovoi projektligjin që sjellim sot në Kuvend, që përcakton këtë datë si ditën e veteranit. Shkak është fakti që më 20 korrik 1957 është krijuar për herë të parë një organizatë e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Besoj se kjo është një arsye e qenësishme që në ligjin përkatës nr. 7874, datë 17.11.1994, në nenin 7 shtohet një paragraf, i cili përcakton në mënyrë përfundimtare

datën 20 korrik, si Dita e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Dua që t'ju shpreh mirënjohjen, zonja kryetare lidhur me rregullimin e orarit, meqenëse jemi të angazhuar si Ministri e Mbrojtjes në drejtimin e sekretariatit të SEEDM-it nga ana e Shqipërisë dhe unë jam caktuar si kryetar i këtij sekretariati u desh ky rregullim kohe që të mund të isha prezent për paraqitjen e këtij projektligji.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Koçi!

Kam parasysh nisur edhe nga përmbajtja e relacionit që shoqëron projektin, se Komisioni për Statusin e Dëshmorit ka qenë një ndër hartuesit kryesorë të këtij propozimi. Për të respektuar zotën Salillari që vjen në emër të këtij Komisioni të nderuar, do të desha t'ia kaloj atij fjalën për të na shpjeguar diçka më tepër rreth arsyeve, rrethanave që ju shtynë në propozimin e datës 20 korrik, si datë në të cilën ne duhet të nderojmë Organizatën e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Behar Salillari – Me ligjin e sipërpërmendur Komisioni Qendror për Statusin e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare bëri të mundur që nga viti 1995 deri në vitin 2017 t'u njihte statusin e dëshmorëve të atdheut rreth 56 mijë e 300 veteranëve, të cilët ishin të kategorizuar në disa pika, përveçse iu njoh statusi iu dha edhe shpërblimi financiar mujor.

Aktualisht, ky numër është në rënie, gjithmonë nga të dhënat që disponojmë. Janë rreth 7 mijë e ca veteranë, që janë gjallë. Nisur nga shqetësime dhe nga problemet në zbatimin në praktikë të ligjit doli se një nga shqetësimet e organizatave të veteranëve ishte dita përkujtimore, e cila nuk ishte zyrtare. Nisur nga ajo që dyja organizata kishin këtë kërkesë, ne morëm këtë iniciativë për ndryshimin e projektligjit.

Organizata më e madhe dhe më aktive është krijuar më 20 korrik të vitit 1957. Organizata tjetër është krijuar pas vitit 1990 më 18 korrik 1994. Duke qenë se Organizata e Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar është organizata më e madhe dhe më aktive, me numrin më të madh të veteranëve, si dhe organizata e parë që është krijuar, ne menduam që të jetë kjo datë e përcaktuar në këtë projektligj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Salillari!

Unë do t'ia jap fjalën zonjës Dhima, e cila është relatore për këtë projektligj.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër për prezantimin!

Faleminderit, zoti përfaqësues i Komisionit për Statusin e Dëshmorëve për prezantimin!

Më vjen mirë që Ministria e Mbrojtjes vlerëson Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe përcakton datën 20 korrik si Dita e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Nëpërmjet projektligjit do të përcaktohet dita e përkujtimit dhe e nderimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për përkushtimin, për sakrificën, për angazhimin dhe për kontributin që ata kanë dhënë në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë. Në këtë datë përkujtime Organizata e Veteranëve, shoqëria civile, institucionet shtetërore, ato qendrore dhe vendore, si dhe organet e pushtetit vendor do të organizojnë aktivitete të ndryshme për nder të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të cilët me kontributin e tyre kanë spikatur me përkushtim në angazhimin e tyre në këtë luftë dhe në ndërtimin e vendit pas luftës.

Në kushtet kur ky projektligj nuk ka efekte financiare, unë do t'ju ftoja, të nderuar kolegë deputetë, që në mënyrë unanime ta miratojmë këtë ndryshim.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Fjala është për kolegët për pyetje apo diskutime.

Po, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kam dy pyetje. Zotëria që e mori fjalën në fund, ishte kryetari i Komisionit për Statusin e Dëshmorëve? Kështu e lexoj këtu, nëse ka ndonjë keqkuptim...

Ermonela Felaj - Ka një pasaktësi.

Petro Koçi - Behar Salillari punon te zyra, e cila trajton çështjet e veteranëve, të dëshmorëve në Ministrinë e Mbrojtjes.

Për sa u përket komisioneve shtetërore për të dyja çështjet janë komisione të tjera: Komisioni Qendror për Statusin e Dëshmorit të Atdheut, që drejtohet nga Ministri i Mbrojtjes, por është edhe një komision tjetër, i riaktivizuar me vendim të Këshillit të Ministrave për të ridhënë statusin e veteranit në të gjitha rastet kur ka një vendim gjykatë të formës së prerë, por jo për raste të tjera, që drejtohet nga zëvendësministri i Mbrojtjes.

Zoti Salillari është një specialist i dedikuar edhe si sekretar i këtyre dy komisioneve për çështjet që lidhen me Luftën Antifashiste, me dëshmorët, por edhe me veteranët.

Myslim Murrizi - Unë nisem nga informacioni që kam përpara. Por gjithsesi përderisa jeni eprori i tij si zëvendësministër e pranoj që është ashtu siç thoni ju. Ju në parashtrimin tuaj thatë se jeni nisur nga një vendim i vitit 1957, data e krijimit të kësaj organizate, a mund të na e vini në dispozicion këtë vendim: nga kush është marrë dhe çfarë date ka ky vendim. Pra, është marrë nga Byroja Politike, nga Komiteti Qendror?

Në fjalën e tij zotit Salillari, ndoshta nuk isha i vëmendshëm, tha se kanë qenë 55 mijë anëtarë të Organizatës së Veteranëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi, mbaroni pyetjen që ai të japë përgjigjen, përndryshe nuk regjistrohet përgjigjja e tij.

Petro Koçi - Janë 56 mijë e 300 e ca dhe kur i rumbullakosim shifrat themi rreth 56 mijë e 500 individë, të cilëve u është njohur Statusi i veteranit. Zoti Salillari tha se, nga të gjitha këta që u është njohur statusi nga viti 1995 deri sa është mbyllur funksionimi i komisionit shtetëror që ka bërë njohjen e statusit. Tashmë janë rreth 7 mijë persona që janë ende gjallë, që e gëzojnë statusin.

Myslim Murrizi - Faleminderit!

Pra, 56 mijë e 300 kanë pasur statusin e veteranit në vitin 1994. 28 mijë thoni që kanë qenë dëshmorë bëjnë 84 mijë. Ndërkohë që në histori kemi mësuar që ushtria nacionalçlirimtare e partizanëve ka pasur 70-75 mijë vetë. Na dalin 9 mijë tepër, nga i keni gjetur?! Çfarë është gënjeshtër këtu: numri i dëshmorëve, numri i partizanëve apo numri i veteranëve? 9 mijë nuk janë pak, nuk na rakordojnë shifrat, del si ajo 7 herë 7.

Të kesh qenë partizan, minimalja duhet të kesh datëlindjen në vitin 1928 që të të kapte moshë 16 vjeç në vitin 1944. Sot i bie të jesh 91 vjeç, ta kesh zhvilluar luftën 12 vjeç, të kesh qenë debatikas nga Coli e këtej. Po të kesh qenë më i madh i bie të jesh edhe më i moshuar. Unë si deputet i kam bërë një kërkesë, edhe Sigurimeve Shoqërore, edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të parë listën e votuesve se sa kemi gjallë në moshën 91, 92 deri te 100 vjeç, i fundit më duket ndërroi jetë para disa ditëve. Përsëri jam shumë skeptik për numrin. Do të doja një vendim të vitit 1957, numrin e saktë se më dalin shumë partizanë, duhet t'i seleksiononi.

Zoti Koçi, është tepricë, ose hiqni dëshmorët, ose numrin e partizanëve ose të veteranëve që të kuadrojnë shifrat!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kanë qenë tamam? Dakord.

Ermonela Felaj - Zoti Murrizi, përfundojeni pyetjen!

Myslim Murrizi – Pyetja ime është: 55 mijë e 300 kanë pasur statusin, 28 mijë na keni thënë se kanë qenë dëshmorë, bëjnë 84 mijë, partizanë kemi mësuar se kanë qenë 75 mijë, 9 mijë ku i keni gjetur? Dalin 9 mijë tepër.

Ermonela Felaj – Kolegu Murrizi, besoj se e përfunduat pyetjen tuaj. Në fakt, pyetja juaj nuk është se ka lidhje me ndryshimin që propozohet në një ligj që ka 25 vjet në fuqi. Megjithatë për respektin tuaj, zoti Koçi do të japë një përgjigje.

Myslim Murrizi - Pse çfarë kujton ti se para 25 vjetësh nuk kanë qenë komunistët në pushtet?

Ermonela Felaj – Nuk ka lidhje, ligji ka 25 vjet në fuqi. Ne nuk po diskutojmë përmbajtjen e ligjit. Ne po diskutojmë një ndryshim që propozohet në ligj.

Myslim Murrizi – Për cilën kategori bëhet ndryshimi, për cilët njerëz?

Ermonela Felaj – Për të gjithë ata që në mënyrë të pakontestuar u është njohur statusi i veteranit.

Myslim Murrizi - Më jepni vendimin e vitit 1957, kush e ka firmosur Koçi Xoxe?

Ermonela Felaj - Zoti Koçi, ju lutem një përgjigje, nëse do të duhet edhe akti i themelimit të Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, nuk besoj që e keni me vete, megjithëse kolegët deputetë kanë një javë që kanë qenë të ftuar për zhvillimin e kësaj mbledhjeje dhe mund të kujdeseshin paraprakisht që ne ta plotësonim me dokumentacion. Në respekt të kolegut të këtij komisioni po ju jap fjalën.

Petro Koçi - Unë i prisja pyetjet me karakter politik, por jo kërkesën për të parë një dokument. Ky është një fakt që dihet historikisht, më 20 korrik 1957 është krijuar për herë të parë një organizatë...

(Zoti Myslim Murrizi flet pa mikrofon)

Nuk ka lidhje me historinë...

Më 28 nëntor 1912, ti nuk ke qenë, por përsëri është një datë që njihet historikisht, pra nuk ka lidhje me ditëlindjen dhe me...

(Zoti Myslim Murrizi flet pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Do t'i drejtohem Arkivit Qendror të Shtetit që të na vendosë në dispozicion aktin e themelimit të Organizatës së Veteranëve.

Petro Koçi - Pyetje me karakter politik, sigurisht që do të ishte çështja e datës së krijimit të organizatës, që nuk ka ndonjë pikëpyetje për këtë, sepse nuk është një falsifikim date, por meqenëse ka qenë periudha e komunizmit, e prisja të bëhej një pyetje e tillë. Por

dua ta krahasoj edhe me një çështje tjetër. Në vitin 1957 është themeluar Universiteti i Shqipërisë për herë të parë, sa herë festojmë hapjen e Universitetit të Shqipërisë, gjithmonë kujtojmë atë datë, pavarësisht se kush ka qeverisur në atë kohë. Prandaj kemi marrë në konsideratë ditën kur është themeluar për herë të parë Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pra, jemi nisur nga kjo logjikë.

Ka edhe një përkatësi tjetër, edhe organizata tjetër është formuar pothuajse në atë datë, pavarësisht se në një vit tjetër, por është afër 20 korrikut, që do të shpallet tashmë, nëse projektligji do të kalojë në parlament si “Dita e Veteranëve të Luftës”.

Për sa i përket moskorrespondimit të shifrave, është një pyetje shumë interesante. E para, nuk merr statusin e veteranit patjetër ai që ka qenë me armë në dorë duke luftuar në rreshtat e formacioneve të ushtrisë nacionalçlirimtare, por janë të gjithë ata që në role, rrethana të tjera janë shpallur veteranë të luftës për shkak të kontributit konkret që kanë dhënë gjatë asaj lufte. Në këtë rast dua t’ju shpjegoj që edhe dëshmor i atdheut që i përket kësaj periudhe nuk duhet patjetër të ketë qenë një partizan me armë në dorë, por mund të ketë pasur funksione të tjera: korrier, bazë e luftës e të tjera që në aksionet hakmarrëse, në vendimet e pushtuesve apo të bashkëpunëtorëve të tyre kanë përfunduar me vdekje.

Ju e dini se kaloi edhe në këtë komision ligji përkatës “Për statusit e dëshmorit të atdheut”. Nuk ka lidhje se duhet të korrespondojë patjetër shifra 56 mijë, plus 28 mijë që të dalë numri i atyre që kanë qenë pjesë e formacioneve partizane, i cili është 73 mijë. Është një logjikë, e cila vlen për të ndërtuar një pyetje, por jo për të nxjerrë një konkluzion të pandryshueshëm.

Për sa i përket moshës duhet pasur parasysh se veteranë quhen të gjithë ata që deri në maj të vitit 1945 në pozicione të ndryshme dhe jo patjetër partizanë kanë luftuar ose kanë qenë pjesë e veprimtarisë antifashiste nacionalçlirimtare. Ju e dini se një pjesë e formacioneve partizane kanë kaluar edhe kufijtë shtetërorë të Shqipërisë për të çliruar pjesë të territoreve të tjera që ishin pjesë e rajonit të Ballkanit. Unë besoj se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare duhet të kthehet në një vlerë që na bashkon të gjithë. Të heqim dorë nga ndarjet, të cilat në logjikën dhe në arsyetimin tim më shumë e marrin shkakun nga pjesa politike dhe qeverisëse e pasçlirimit. Pjesa e luftës mendoj se duhet të jetë qartazi një pjesë e historisë që duhet të na bashkojë të gjithëve, pavarësisht nga rreshtimi në formacionet e sotme politike.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Koçi!

Ju lutem, të respektojmë radhën!

Kush ka pyetje, para se të kalojmë te diskutimet?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Pa dyshim që ky korrigjim, ndonëse i vonuar për caktimin e datës së Organizatës së Veteranëve është një masë e rëndësishme apo një propozim në kohë i qeverisë në kuadër edhe të festimit të 75 -vjetorit të çlirimit të vendit, e plotëson këtë boshllëk. Pra, kemi të bëjmë thjesht me rivendosje apo me piketim të një date, e cila duhet të përkujtohet, jo vetëm nga veteranët, por nga i gjithë populli shqiptar. Sot është dita që ta miratojmë. Madje sot është dita që të mbajmë edhe një minutë heshtje për veteranin 100 vjeçar Rahman Parllaku, por kjo le t'i mbetet seancës plenare, sepse figura e tij është një figurë e ndritur e Luftës Nacionalçlirimtare. Unë mendoj që ta miratojmë këtë ndryshim.

Ermonela Felaj - Ka diskutime nga kolegë të tjerë?

Ka një ndërhyrje të dytë nga zoti Murrizi.

Myslim Murrizi - Nuk është ndërhyrje, por dua të them dy fjalë. Pasi mora përgjigje shteruese nga zoti Koçi për pyetjet, pashë që përveç përgjigjeve për pyetjet filloi të bëjë një farë morali dhe histori.

Zoti Petro, me thënë të drejtën nuk kam nevojë për histori, jam i tejngopur, sidomos me histori komunistësh. Në respekt të njohjes së hershme së bashku, pasi kemi qenë në parlament në vitet 1997-2001 nuk do të doja nga ti histori fare. Llogoret politike pas vitit 1990 janë të përcaktuara: unë nuk vij tek ti, ti nuk vjen tek unë. Kjo është çështje si ta ndiesh, përveç Kastriot Islamit që erdhi nga ti, këtej. Problemi është që shifrat duhet të jenë të besueshme, por në ato libra që prej vitit 1948 fituesit janë tallur me historinë. Unë nuk jam kundër luftës, mirë ne që nuk e patëm atë fat, as unë, as ti, por duhet që fëmijët tanë, që na merrnin çdo 5 maj dëshmorë, herë thoni i vumë gjermanët para këtu, herë thoni se na vunë gjermanët para atje”, njerëz që s'kishin lidhje me luftën.

Pas njëzet e nëntë vjetësh postkomunizëm nuk kemi pse të tallemi më me shqiptarët. Nuk ka arsye që fëmija im të mësojë nëse kemi pasur shtatëdhjetë mijë partizanë, shtatëdhjetë e tre mijë, shtatëdhjetë e pesë apo tetëdhjetë e katër, sa dalin me shifra. Nuk kam pse shoh me shall të kuq në qafë veteranë lufte që kanë lindur mbas prishjes së kooperativave. Është turp.

Ata që kanë qenë në luftë, aq sa të jenë gjallë, por që kanë qenë realisht në luftë, jo ata që u paskan çuar çorape partizanëve, që kanë ngrënë e kanë pirë a ku di unë çfarë kanë bërë, paskan raportuar për të vrarë nga Mustafa Gjinishi e deri në fund, marrkan statusin e veteranit të luftës.

Përderisa flasim për luftë, megjithëse ju nuk e njihni, lufta ka periudhën nga 1939-a me Mujo Ulqinakun e deri më 24 maj të vitit 1944, kur u krijua qeveria e Përmetit.

Unë di që mbas 24 majit të vitit 1944, as Partia e Punës nuk paguante 1200 lekë. Ehu, sa i gjatë shkoi rreshti për të marrë atë 1200-lekëshin si veteran në kohën e kooperativës. Jo, jo. “Kur ke ardhur ti, në dyzetegjashtë? S’ka pasur luftë më”. Me kë kanë luftuar këta?

Prandaj duhet të jemi të qartë edhe në lidhje me dëshmorët. E kam thënë edhe në parlament, kur kam folur: unë nuk tallem me ta, por 5, 3 dëshmorë për qendër votimi është absurde. Pa mi gjeni! Ja ku jeni deputetët këtu. M’i gjeni. Ti je i vjetër në politikë. M’i gjeni. 5508 qendra votimi kemi ne. Njëzet e tetë mijë dëshmorë! Për çfarë? Për të bërë si vëllezërit tanë rusë në kohën e komunizmit, me një dëshmor për çdo kilometër katror?

Ngrini një komision. Jua thashë: do t’ju sponsorizoj edhe unë, me sa të kem takat, jua lë rrogën gjashtë muaj. Shkoni e numërojeni varrezat e dëshmorëve se sa janë! Na thoni ekzakt sa janë, sepse po të jenë vrrarë 28 mijë, me 124 gjermanë e 315 italianë, i bie që një nga ata armiq, për të cilët kemi thënë se kanë ikur, të ketë vrrarë 70 trima nga këta tanët.

Kjo është denigruese. Në qoftë se nga kjo ushtri prej shtatëdhjetë mijë vetash, që thoni ju, janë vrrarë njëzet e tetë mijë, pra 40 %, atëherë paska qenë turmë, popull, një popull që ka ikur në ekzil.

Prandaj, na e thoni ekzakt, mos ecni me frymën se kështu e ka thënë që nga viti 1945 partia jonë, ajo që kemi qejf ne, dhe kështu do të themi edhe ne. S’ka asgjë të keqe të reduktohet numri, por ama të jetë real numri i veteranëve, numri i dëshmorëve, numri i këtyre që morën shpërblim financiar. S’ka asgjë të keqe.

Kush ka qenë në luftë asokohe, që ka qenë në luftë realisht, le ta marrë shpërblimin financiar. Nuk është se unë jam kundër luftës. Nuk e shoh bardh e zi dhe nuk vi nga ish-komunizmi, që të kapërcej ylberin dhe të bëj parti tjetër. Unë nuk kam qenë anëtar i Partisë së Punës. Kam qenë student i Dhjetorit. Nuk kam qenë sekretar partie, s’kam kapur njeri nga favoritët dhe as u kam shqyer pantallonat e ngushta. Kam tjetër pikëpamje dhe tjetër ide në lidhje me zhvillimin e politikës. Nuk mundem që për 29 vjet të dëgjoj pallavrat e çdo lloj komunisti nostalgjik në këtë sallë e në atë sallë të Kuvendit, që paskemi bërë luftë heroike! Ku pra? Janë vrrarë 28 mijë vetë. Ku?

Unë shoh Lushnjën. Ne kemi 238 qendra votimi, e duhet të kemi 1234 dëshmorë. Ku janë? Hajde, të ftoj publikisht! Ta paguaj unë atë... Hajde të numërojmë varrezat e dëshmorëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përralla ke bërë ti, Spartak, gjithë kohën. Të kemi dëgjuar pesëdhjetë vjet dhe na ke bërë për të vjellë me përrallat tuaja. Hajde, gjeje Spartak, sa dëshmorë ke në shtëpinë tënde, në fshatin tënd! Na mbytën përrallat.

Ermonela Felaj – Nuk ka nevojë të përdoret ky ton.

Myslim Murrizi – Po çfarë toni kërkoni? T’i them Spartakut që gënjen? Nuk i them...

Ermonela Felaj – Nuk jeni vetëm ju dhe zoti Braho në këtë mbledhje. Janë më shumë se kaq njerëz.

Myslim Murrizi – I thuaj pra, që të mos më ndërhyjë. Se kur ndërhyjnë ai, unë e trash tonin.

Ermonela Felaj – E para kjo. E dyta: kërkoj mirëkuptimin tënd...

Myslim Murrizi – Mirëkuptimi im është këtu: unë kërkoj...

Ermonela Felaj – Ne nuk jemi mbledhur këtu të shpalosim njohuritë tona historike.

Myslim Murrizi – Unë s’bëj histori fare.

Ermonela Felaj – Ato i diskutojnë dhe i vendosin historianë. S’do t’i vendosim ne këtu.

Myslim Murrizi – Historinë në Shqipëri e ka bërë politika, se po që për historianët, unë u heq kapelën.

Ermonela Felaj – Sepse kështu shndërrohet në lojë kungulleshke: jo ishin kaq, jo ishin aq. Me çfarë të drejte e bëjmë ne historinë e këtij kombi?

Myslim Murrizi – Unë kam të drejtë të flas...

Ermonela Felaj – Ne nuk bëjmë dot historinë e këtij kombi. Ne vendosim për shumë gjërat që na kanë ardhur këtu dhe për një ligj që ka 25 vjet në fuqi.

Myslim Murrizi – Kështu do ta bësh historinë ti? Ma jep letrën e 57-ës. ma jep letrën e ’57-ës!

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi, çfarëdo vërejtjesh të keni ju, kjo nuk mund të vërë në dyshim...

Myslim Murrizi – Çfarë je, edukatore je, që më ndërpret fjalën? Mos ma ndërprit fjalën!

Ermonela Felaj – Po nuk mundet, sepse është një ngjarje që e kujtojnë të gjithë popujt.

Myslim Murrizi – Mos ma ndërprit fjalën fare! As më intereson fare se çfarë mendon ti për ngjarjen.

Ermonela Felaj – Mirë pra, dakord! Përfundoje diskutimin!

Myslim Murrizi – Mos ma ndërprit fjalën mua!

Ermonela Felaj – Përfundoje diskutimin!

Myslim Murrizi – Ma jep vendimin e '57-ës.

Ermonela Felaj – Unë drejtoj mbledhjen.

Myslim Murrizi – Pse drejton mbledhjen, s'je pronare e mbledhjes.

Ermonela Felaj – Vendim i themelimit të organizatës së veteranëve të luftës nuk është objekt i kësaj mbledhjeje.

Myslim Murrizi – Ma jep ta shikoj!

Ermonela Felaj – Me firmën tuaj ia kërkojmë Arkivit të Shtetit, që ta marrim.

Myslim Murrizi – Dakord, dakord!

Ermonela Felaj – Nuk është organizatë që varet nga Ministria e Mbrojtjes, që t'ia kërkoj dokumentin Ministrisë së Mbrojtjes.

Myslim Murrizi – Atëherë po të drejtohem ty: cila është pikënisja që ke propozuar...

Ermonela Felaj – Organizata krijohet me vullnetin e lirë të atyre që kanë ndihmuar dhe kanë marrë pjesë në Luftën Nacional-Çlirimtare

Myslim Murrizi – Cila është pikënisja që ke shpallur datën 21 korrik? Pse jo më 20 korrik? Nga jen nisur?

Ermonela Felaj – Më duket që jua shpjegua. Është data e themelimit.

Myslim Murrizi – Nuk të besoj ty fare. Për mua je e pabesueshme. Edhe Petroja gjithashtu. Më jepni një letër, që ta shoh.

Ermonela Felaj – Mund të mos e votosh.

Myslim Murrizi – Po pra! Më jepni një letër! As bëhet fjalë që s'do ta votoj, por më jep një letër, që ta besoj.

Ermonela Felaj – Në lidhje me letrën, ta shpjegova...

Myslim Murrizi – Historinë nuk e bën ti, Ermonela!

Ermonela Felaj – As ju nuk e bëni historinë, e as ndonjë nga ne nuk e bën historinë.

Myslim Murrizi – Po ta them: gjeje numrin e thuaje.

Ermonela Felaj – Ne mund ta shfrytëzojmë këtë mbledhje për të bërë një diskutim tjetër, që s'ka lidhje me këtë pikë.

Myslim Murrizi – Ka shumë lidhje.

Ermonela Felaj – Ju shumë mirë mund të thoni: mua nuk më mbushet mendja për datën 20 korrik, nuk e kam dokumentin, e njëra e tjetra.

Myslim Murrizi – Nuk më mbushet mendja për numrat.

Ermonela Felaj – ...një diskutim që bëhet në Shqipëri tash 100 vjet: kush ishte në luftë, sa ishin në luftë, më duket absurde.

Myslim Murrizi – Nuk është bërë fare ky diskutim.

Ermonela Felaj – I takon këtij brezi të vitit 2019, vit në të cilin jemi.

Myslim Murrizi – Po a ka më turp se fakti që ky brez është helmuar nga propaganda komuniste?

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi, unë them se fëmija im, fëmijët tuaj dhe fëmijët e të gjithëve duhet të mësojnë diçka.

Myslim Murrizi – Çfarë të mësojnë fëmijët tanë?

Ermonela Felaj – Duhet të mësojnë diçka...

Myslim Murrizi – Çfarë, për shembull?

Ermonela Felaj – Më dëgjo, se unë po të respektoj dhe nuk po bërtas! Ajo çfarë i shkaktoi Lufta e Dytë Botërore njerëzimit nuk duhet të harrohet. Kjo është e rëndësishme të mësohet.

Myslim Murrizi – Cilit njerëzim?

Ermonela Felaj – Njerëzimit, njerëzimit.

Myslim Murrizi –Jo, ajo çfarë i shkaktoi këtij vendi komunizmi nuk duhet të harrohet.

Ermonela Felaj – U vranë njerëz, të cilët s’kishin lidhje fare me asnjë parti politike. U vranë civilë, u gjymtuan civilë me miliona. Prandaj bota...

Myslim Murrizi –Sa janë vranë?

Ermonela Felaj – Prandaj bota më 9 maj mbledhet gjithmonë dhe përkujton ditën e fitores së popujve antifashistë.

Myslim Murrizi – Po ç’punë ke ti me botën?

Ermonela Felaj – Ne jemi një ndër ata popuj, dhe duhet të krenohemi për këtë gjë.

Myslim Murrizi – Me çfarë të krenohemi? Me regjimin bastard të atyre që ke ti qejf? Me çfarë të krenohemi?

Ermonela Felaj – Ju lutem, zoti Murrizi, më duroni edhe një fjalë, dhe...

Myslim Murrizi – Mua mos më ndërpre fjalën, po të them prapë. Mos bëni debat kur flas unë.

Ermonela Felaj – Fjalën e ke, mikrofonin e ke të ndezur.

Myslim Murrizi – Unë e kam ndezur, dhe nuk ke nevojë të më korrigjosh.

Ermonela Felaj –Nuk po ta pres fjalën. Mikrofonin e ke të ndezur. Ju lutem, jepini fund diskutimit, se do të diskutojnë edhe të tjerë.

Myslim Murrizi – Deri në dhjetor të 1990-ës janë vrarë 8300 shqiptarë. më tregon mua historinë ti. Çfarë historie do ti?

Ermonela Felaj – Nuk kam ndërmend fare të të tregoj historinë, se nuk kam mbaruar për histori. Por edhe sikur, prapë nuk do ta bëja.

Myslim Murrizi – Ti e pëlqen, ta gëzosh! Unë s’e pëlqej hiç!

Ermonela Felaj – Kaq! Nuk do ta bëja, sepse nuk jam historiane.

Myslim Murrizi – Nuk po ta heq njeri enverizmin ë ke në shpirt. Mbaje, ta gëzosh! Vetëm me shifrat mos u tallni! Kaq! Pse po ta heq enverizmin unë ty? Mbaje! Shko më 5 maj atje! Shko te varri i Enverit! Bëj çfarë të kesh qejf! Sepse, në fund të fundit, unë të paktën, për këtë kam luftuar në atë Dhjetor të nëntëdhjetës: që secili të jetë i lirë. Por jo që atë që beson ti të ma imponosh edhe mua si mashtrim.

Unë po të kërkoj shifrat dhe nuk po të flas për politikë. Por po t’i hyjmë çështjes se fituam ne në 1944-ën apo u pushtuam për së dyti, ec e gjeje, pyet ata që kanë vuajtur!

Unë po them se partizanët nuk na dalin, dëshmorët nuk na dalin, që veteranët dhe dëshmorët e kapërcejnë numrin. Kaq po them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S’jam fare kundër luftës unë. Jam pro, dhe shumë madje, por mos na spekuloni me shifrat. Prandaj po them: më jepni atë vendimin e ’57-ës, që ta kem. S’ke qejf ta sjellësh? Doni të votoni? Votoni. Datë veteranësh edhe 16 tetorin bëni, apo 18-ën e Ramizit. Cilën datë të keqni qejf. I keni numrat, votoni!

Unë po them: që të jemi të qartë me veten, ma gjej një kopje të vendimit. Po e gjete. Në s’ka, s’ka. edhe numrat dhe shifrat rakordojini! Këtë e kam thënë në parlament. Nuk kam asgjë me të. Por unë nuk mund të besoj më...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Harusha, le ta përfundojë fjalën e tij zoti Murrizi, e pastaj ju do të merrni fjalën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke i ndërhyrë juve, i jepni shkak që të vazhdojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Në qoftë se unë ju kam ngrënë kohën...

Ermonela Felaj – Si mund t'i respektojmë rregullat, kur Rregullorja thotë: bëhen pyetje, bëhen diskutime për rendin e ditës.

Myslim Murrizi – Fol, mor burrë, se e mbarova fjalën! Në respekt të Luanit...

Ermonela Felaj – Tani, sikur të bëjmë mbledhje për çdo gjë që ndodh gjatë ditës, do të thotë që ne të mos mbarojmë kurrë.

Myslim Murrizi – Luan, në respekt që ke kërkuar fjalën, unë e mbarova fjalën time. Inshallah më gjeni ndonjë numër.

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Me gjithë respektin ndaj këtij projektligji, falënderoj zotin zëvendësministër.

Në fakt, ky projektligj është pak me vonesë, por më mirë vonë se kurrë. Sepse të gjithë kanë marrë statuse këtu, dhe vetëm veteranët kishin mbetur pa marrë statusin.

Unë ju ftoj ta votoni këtë projektligj.

Kaq kisha!

Ermonela Felaj – Statusin...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

...që do t'i nderosh, nuk e kishin.

Ka kolegë të tjerë, që duan fjalën?

Mirë. Atëherë mbyllet këtu diskutimi në lidhje me ndryshimin e propozuar.

Kush është dakord në parim me ndryshimin e propozuar në ligjin “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”?

Kush është kundër? Vetëm një koleg është kundër. Abstenim? Një abstenim.

Pjesa tjetër voton për projektligjin, kështu që projektligji miratohet në parim.

Projekti ka vetëm dy nene. Kush është dakord me nenin 1 të projektit? Po, faleminderit! Kundër? Abstenime? Mbetemi në të njëjtin trend votimi.

Miratohet neni 1 i projektligjit!

Neni 2 i projektligjit ka të bëjë me hyrjen në fuqi, që është në afatin e zakonshëm.

Kush është dakord me nenin 2 të projektligjit? Po, faleminderit, koleg! Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 2!

Kush është dakord me ndryshimin e propozuar në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”?

Po, faleminderit! Kundër? Abstenim 1.

Miratohet edhe projektligji!

Faleminderit, zoti Koçi dhe zoti Salillari për prezencën tuaj në Komisionin e Sigurisë.

Ditë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se mbylлим këtu mbledhjen, pas votimit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund t'i thoni gjërat jashtë.

Zoti Koçi, faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit shumë! Besoj se shqiptarët do të jenë tërë jetën krenarë për rolin që kanë luajtur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ne u rreshtuam në krahun e duhur, dhe besoj se kemi luajtur edhe një rol ndërkombëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem kolegë, se mbledhja nuk ka mbaruar. Një minutë! Kolegë, më duhet t'ju bëj me dije...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegë, më duhet t'ju bëj me dije se më datë 12 shtator, me shkresën nr. Protokolli 3228, të Kuvendit të Shqipërisë, kuptohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, më është kaluar kërkesa e disa kolegëve deputetë, drejtuar Komisionit për Sigurinë Kombëtare, të cilën po e lexoj. Kërkesa mban datën 10. 9. 2019:

“Mbështetur në nenin 36 të Rregullores së Kuvendit, nisur nga një deklaratë e bërë më 9. 9. 2019 nga Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e tij zoti Ilir Meta, në Komisionin Hetimor, për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, i cili u shpreh se një ditë para se të shpallte datën e anulimit të datës së zgjedhjeve lokale të 30 qershorit, kishte marrë informacion se persona të caktuar do të shfrytëzonin mitingun e paralajmëruar nga opozita, mes të tjerave edhe për djegien e Kuvendit, kërkojmë: të thirret në Komisionin e Sigurisë Kombëtare drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror, zoti Helidon Bendo, për të dhënë informacion më të detajuar në lidhje me sa më sipër.”

Kjo kërkesë është nënshkruar nga deputetët: Xhemal Qefalia, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Lefter Maliqi, Myslym Murrizi, Luan Duzha dhe Elena Xhina.

Sigurisht, si kryetare, unë jam e detyruar t'jua bëj me dije, që të vendosim në lidhje me fatin e kësaj kërkesë. Sigurisht, nga pikëpamja formale kërkesa është në rregull, sepse plotëson numrin e kërkuar për të bërë një seancë dëgjimore me një drejtues të një institucioni të rëndësishme kombëtare, siç është Shërbimi Informativ i Shtetit. Pra, kjo kërkesë është korrektë në pikëpamje formale, por unë kam parasysh se Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin e tij nr. 84 ka vendosur ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Ky vendim i Kuvendit ka shërbyer për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Hetimor, i cili është duke mbledhur të gjitha provat dhe faktet në lidhje me akuzën për të cilën është ngritur edhe hetimi parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë.

Kësisoj, sigurisht që kërkesa do të pranohet, por data e seancës dëgjimore me zotin Helidon Bendo do të jetë pasi që Komisioni Hetimor të ketë administruar si provë pyetjen e tij. Është një proces për të cilin kemi rënë të gjithë dakord, pra që të ngrihet Komisioni i Posaçëm. Nuk mund të ndërhyjmë. Vendimi i Kuvendit dhe Kodi i Procedurës Penale nuk na lejon të ndërhyjmë në marrjen e kësaj prove përpara se ta ketë administruar komisioni, dhe për atë komision kjo është një provë. Kësisoj, doja ta ndaja këtë sot me ju.

Ne do ta zhvillojmë një ditë të mëvonshme, pasi që Komisioni Hetimor ta ketë administruar si provë. Në dijeninë time, që të nesërmen e bërjes së kësaj deklarate, Komisioni Hetimor i ka nisur shkresat përkatëse Presidentit të Republikës dhe Shërbimit Informativ. Pra, është në procesin e grumbullimit të provave. Kështu, ne nuk mund të ndërhyjmë, sepse normalisht do të krijojmë ndikime në një hetim, i cili do të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të paanshme, për aq sa mundet.

Myslim Murrizi – Më fal, në dijeninë tuaj, Komisioni Hetimor ka kërkuar shkresë nga Helidoni apo ka thirrur Helidonin në Komision?

Ermonela Felaj – Komisioni Hetimor, i drejtuar nga zoti Manja, edhe tashti që po flasim, është duke zhvilluar mbledhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, ne s'e kemi mbaruar, dakord, se ju erdhët pak më vonë. Atëherë, është e qartë se Komisioni Hetimor do të duhet të hedhë dritë mbi atë që tha Presidenti i Republikës. Komunikimi i Komisionit Hetimor me Presidentin e Republikës në lidhje me këtë fakt, di që është bërë publik nga zoti Manja. Ndërkohë, na mjafton të gjithëve, se është logjikë e thjeshtë: ata janë duke hetuar mbi këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, po, çështja në fjalë ka ngërthyer edhe Shërbimin Informativ të Shtetit, sepse tanimë është bërë deklarimi publik nga ana e Presidentit të Republikës, që ka pasur një informacion nga ana e Shërbimit Informativ. Që Shërbimi Informativ të informojë Presidentin e Republikës apo Kryeministrin, kjo nuk është një gjë e re, sepse atë detyrë ka dhe nga ato institucione varet. Nuk informon komisionin tonë parlamentar, por është i detyruar që kur e kërkojmë, të raportojë para nesh në lidhje me veprimtarinë, buxhetin, pra ato raportime që ne i kemi ndjekur në mënyrë periodike.

Pra, kërkesa pranohet, por nuk mund të bëhet tani. Për të gjithë ata që e njohin hetimin, është si të shkosh të bësh veprime në vendngjarje pa ardhur prokurori. Nuk mundesh. Të gjithë ne këtu kemi rënë dakord, që të hetojë ai komision në lidhje me këtë fakt. Nuk është e mundur që ne të futemi në mes, me atributin që na e jep Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai është Komision i Posaçëm, i ngritur në bazë të ligjit përkatës, sepse ka një ligj të veçantë për funksionimin e komisioneve hetimore, sikundër ka edhe një vendim të Kuvendit të Shqipërisë, që është miratuar me unanimitet, në mos është miratuar me një shumicë shumë më të madhe se ne, ose ne këtu kemi qenë miratues të atij vendimi.

Kështu, është thjesht kjo arsye procedurale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po është arsye procedurale ligjore, e cila nuk na lejon neve, që ndërkohë kur një organ është duke hetuar për këtë çështje, të bëjmë një hetim paralel. Nuk mund ta bëjmë këtë. Mbasi që ata ta kenë administruar si provë, ne do të mund ta thërrasim zotin Bendo.

Luan Harusha – Sipas Presidentit, informacionin e ka marrë nga kryetari i SHISH-it. Po këtu, te Komisioni i Sigurisë, a është dashur të jepte një informacion?

Ermonela Felaj – Jo, nuk është i detyruar në një rast të tillë, kur nuk e dimë nëse ka ndodhur ose jo. Në asnjë rast në fakt. Shërbimi Informativ i Shtetit nuk është institucion që informon komisionin parlamentar. Të jemi të qartë. Nuk ka varësi nga komisionet parlamentare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo pra, jo. Presidentit, Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm e të tjera. E ka të përcaktuar në ligjin e vet organik.

Luan Harusha – Vetëm Presidentit apo edhe Kryeministrit e disa institucioneve të tjera?

Ermonela Felaj – Shërbimi Informativ Shtetëror vepron mbi bazën e ligjit të vet organik. Ju e dini se drejtuesin e Shërbimit Informativ Shtetëror e propozon Kryeministri dhe e emëron Presidenti i Republikës. Ai është i orientuar në ligjin përkatës se si duhet të veprojë.

Komisioni ynë parlamentar nuk është një komision ku ai është i detyruar të informojë në lidhje me të dhënat që merr gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet. Vjen një herë në vit në komisionin tonë parlamentar, vjen për çështje të buxhetit, dhe në fillim të vitit pasardhës vjen për të raportuar edhe për veprimtarinë e një viti më parë. kaq është e gjitha.

Duhet të kuptohet kjo, sepse informacionet që disponon Shërbimi Informativ Shtetëror nuk janë informacione që mund të ndahen me këdo, sepse janë informacione konfidenciale, të cilat u shërbejnë Sigurisë Kombëtare. Pra nuk mund të shkojnë kudo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Vorpsi, ky nuk është një vendim i kryetares. Kam folur me kryetarin e Komisionit të Posaçëm, është në dijeni Kryetari i Kuvendit, po për vërtetësi të gjërave, sepse ne nuk mund të mohojmë se është bërë kjo kërkesë, kërkesa do të pranohet, seanca do të bëhet në një moment të dytë. Kështu që, nuk ka çfarë të diskutojmë më tej dhe as të shtrojmë pyetje para medies.

Myslim Murrizi – Po na e bën këtë si Sulo Gradeci dikur. Ai është një institucion kushtetues. Ne jemi Republikë Parlamentare, Ermonela! As dua t'ia di fare se ku çon shkresa ai gjatë kohës që është në punë. Sa i takon Komisionit të Sigurisë Kombëtare, deputetëve që janë të pajisur me certifikatë sigurie, ai është i detyruar të vijë këtu e të raportojë në lidhje për çfarë e kërkojmë ne.

Ermonela Felaj – Po, patjetër.

Myslim Murrizi – Nëse atij i duket vetja si Kim Philby apo si shef i CIA-s,

Ermonela Felaj – Po nuk thamë se nuk do të vijë.

Myslim Murrizi – Edhe ti po e trajton ashtu. Nëse ke marrë urdhër politik, kjo është tjetër punë.

Ermonela Felaj – Jo, unë po respektoj Komisionin Hetimor.

Myslim Murrizi – Jo, sepse the: kam folur me të tjerë. Ne jemi firmëtarët e kërkesës, që ai të vijë këtu.

Ermonela Felaj – Unë e kam pak të vështirë, në fakt...

Myslim Murrizi – Ti e ke të vështirë, atë në thuaj!

Ermonela Felaj – Jo, e kam pak të vështirë të kuptohem me ju për disa gjëra, në lidhje me çfarë po them. Komisioni Hetimor e ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e ligjit, mbi bazën e Rregullores, mbi bazën e Kodit të Procedurës penale. Tani, për këdo që ka sadopak njohuri në lidhje me Kodin e Procedurës Penale, është e qartë se nuk mund të ndërhyhet në procesin e administrimit të provës nga organi i cili është ngarkuar ta administrojë atë provë. Nuk mundesh.

Myslim Murrizi – Unë të pyeta: kanë thirrur Helidonin apo i kanë kërkuar shkresat? Unë po pyes drejtpërdrejt.

Ermonela Felaj – Nuk e di. Nuk e drejtoj unë atë komision, që të vihem unë në dijeni.

Myslim Murrizi – Në bazë të kërkesës sonë, ti mund të bashkërendosh me kryetarin e komisionit, pyete! I thuaj: nëntë deputetë të Komisionit të Sigurisë...

Ermonela Felaj – Mirë pra, dakord! Unë di këtë që dini ju, që di i gjithë publiku, se ky komision është ngritur për të provuar këtë akuzë. Presidenti i Republikës pretendon se ka pasur një informacion. Është normale që Komisioni hetimor të provojë nëse ky informacion ekziston apo nuk ekziston, çfarë u bë me këtë informacion e të tjera e të tjera. Këto janë gjëra që merren me mend, gjëra të cilat është duke i bërë ky komision.

Myslim Murrizi – Kush na pengon ne që të thërrasim Helidonin?

Ermonela Felaj – Pikërisht kjo na pengon. Ky është një proces në vijim për Presidentin e Republikës. Ne do ta thërrasim Helidonin në momentin që të jetë administruar kjo provë nga Komisioni Hetimor. Pasi ata të kenë mbaruar punë me drejtuesin e SHISHIT, me Presidentin e Republikës e me këdo tjetër që ua merr mendja atyre...

Myslim Murrizi – Ne nuk kemi thirrur Presidentin këtu, Ermonela.

Ermonela Felaj – Mirë pra, dakord, ne nuk e thërrasim Presidentin e Republikës...

Myslim Murrizi – Ne kemi thirrur Helidon Bendon.

Ermonela Felaj – Ai është drejtues i një institucioni që është i përfshirë në këtë hetim. Këtë jam duke thënë. Kaq e thjeshtë është. Ne do të spetojmë kohën e mbledhjes.

Myslim Murrizi – Se na the: nuk i jep ai informacione çdo lloj njeriu. Ku raporton ky njeri, nëse nuk raportuaka në Komisionin e Sigurisë, para atyre deputetëve që kanë certifikatë e sigurie dhe plotësojnë kriteret ligjore? Ku raporton ky?

Ermonela Felaj – Nëse kjo kërkesa juaj nuk do të lidhej, fjala vjen, me këtë çështje, që është duke e zhvilluar një komision tjetër parlamentar, ai do të kishte ardhur patjetër.

Myslim Murrizi – Ne të gjithë së bashku, pa dallime politike, edhe kur ka ardhur këtë vit, kemi qenë dakord që ata duhet të raportojnë këtu, jo të na lexojë neve se sa naftë ka harxhuar dhe sa lekë janë harxhuar për brekë e kanotiere.

Ermonela Felaj – Ato çështje ne i kemi diskutuar me drejtuesit e SHISH-it dhe...

Myslim Murrizi – Duhet të raportojë te ata deputetë që kanë certifikatë sigurie.

Ermonela Felaj –... dhe kemi kërkuar që seanca e raportimit të jetë e një formati të ndryshëm nga ai që historikisht është zhvilluar në Kuvendin e Shqipërisë.

Myslim Murrizi – Këtë herë e kemi kërkuar enkas.

Ermonela Felaj – Mirë, dakord! Po pra, po. Askujt nga ju nuk po i mohohet kërkesa, por nuk mund ta bëjmë tani. Kaq është. Unë nuk mund të çoj drejtuesit të SHISH-it një shkresë në emër të Komisionit të Sigurisë, në emrin tuaj, në momentin kur është një komision tjetër që po heton në lidhje me këtë çështje. Kaq ishte e gjitha! S'ka absolutisht asgjë tjetër për t'u vënë në dyshim. Atë që ju do të donit të sqaronit me drejtuesin e SHISH-it, patjetër që do t'i keni të gjitha mundësitë për ta sqaruar.

Faleminderit!

Pavarësisht toneve, në fund, ne në komisionin tonë kuptohemi.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA

